



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.172/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.172/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike.

A r s y e t i m

Me datë 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 30.09.2019, rreth orës 18:23, në Komunën e Ferizajit, përballë postës, afër 8 metra larg hyrjes së postës, është parë një poster i vendosur, i cili poster i takon njërit nga kandidatët për deputetë nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Mustafa Grainca, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht dispozitën e nenit 3 par.3, pika 4, të kësaj Rregulle zgjedhore.

Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të posterit të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Mustafa Grainca, në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se vendosja e posterit është bërë nga simpatizuesit e kandidatit për deputet Mustafa Granica, duke shtuar se nga ana e këtij subjekti politik janë ndërmarrë masa përmirësuese, ashtu që është bërë largimi i posterit në fjalë, për çka edhe kanë bashkangjitur një fotografi si dëshmi se është përmirësuar shkelja.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë, si dëshmi për pretendimet e tij, përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur një deklaratë të Mustafa Graincës, e cila mban shenjën LRP.Nr.06413/2019 e datës 16.09.2019 dhe disa fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, siç pretendohet në ankesë, sepse posterit i

kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim të materialit propagandistik për fushatë zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posteri i kandidatit në fjalë, është vendosur në afërsi të institucioneve publike, përkatësisht në distancë prej 8 metrash larg hyrjes së postës, e cila gjendet në Komunën e Ferizajit, Paneli vlerëson se në një rast të tillë, ky veprim, në këtë kohë, nuk përbën shkelje të Rregullës zgjedhore të sipërcituar, për faktin se sipas Rregullës Zgjedhore, Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, në nenin 1, ndër të tjera përcaktohet se: *”Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë: organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, përmbajtjen e materialeve të shtypura të fushatës zgjedhore, rastet e veprimeve para ditës së zgjedhjeve ...”*, nga kjo rezulton se këto veprime të subjektit në fjalë nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore siç pretendon paraqitësi i ankesës ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti afër të cilit pretendohet se është vendosur posteri, shërben si Qendër e Votimit, ku sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 172/2019 më datën 04.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.